KEK-u – Divizioni i Prodhimit të Qymyrit (DPQ) nuk posedon asnjë Leje për Punë të Posaçme / Leje për Aktivitetet e Veçanta për pajisjet xehetare në sistemet e djerrinës, qymyrit dhe seperimit. KEK-u duhet të aplikojë në KPMM për tu pajisur me Leje për Aktivitetet e Veçanta për pajisjet, stabilimentet dhe teknologjinë e angazhuar në DPQ, respektivisht për ekskavatorët, konvejerët, palosësit, shiritat transportues dhe pajisjet e stabilimentet tjera përcjellëse.

Aspektet e sigurisë në KEK për vitin 2010

Në kuadër të kompetencave dhe detyrave, inspektorët e Inspektoratit të KPMM kanë bërë inspektimin e rasteve të lëndimeve të rënda në punë.

Gjatë vitit 2010 është bërë inspektimi i rregullt vjetor në Departamentin e Djerrinës dhe inspektimi i pajisjeve xehetare me ç’rast janë dhënë vërejtjet në parregullsitë dhe afatet për evitimin e tyre.

5.4.2. New Co Ferronikeli Complex L.L.C

Minierat e nikelit “Gllavica” në Medvec të Lipjanit dhe “Çikatova e Vjetër” e Drenasit (vendburimet: “Dushkaja dhe Suka”) janë privatizuar nga kompania ndërkombëtare “Alferon” në vitin 2007.

Kjo kompani është pajisur me Licenca për shfrytëzim të nikelit për dy minierat : në Çikatovë të Vjetër (Dushkaja-faza e dytë) dhe në Medvec (vendburimi “Gllavica”).

Inspektorët e Inspektoratit në bazë të detyrave dhe kompetencave gjatë vitit 2010 e kanë bërë inspektimin e minierave të nikelit, stabilimenteve e pajisjeve të nyjës xehetare me objektet përcjellëse si dhe transportin hekurudhor.

5.4.3. Fabrika e Çimentos në Han të Elezit

“Sharr Beteiligungs” GmbH është pajisur me licenca të shfrytëzimit nga KPMM si në vijim:

1. Licencë për shfrytëzim **Nr. 536/KPMM/06** e datës 29.11.2010 për mergel me numër protokolli 3521. Zona e licencës përfshin një sipërfaqe prej 61304.13m². Afati i kësaj Licence është 8 vite, nga 07.06.2006 deri më 06.06.2014
2. Licencë për shfrytëzim **Nr. 544/KPMM/06** e datës 13.09.2006 për mergelës me nr. protokolli 3520. Zona e licencës përfshin një sipërfaqe prej 42.70.57 ha. Afati i kësaj licence është 17 vite nga 07.09.2006 deri më 06.09.2023

Në kuadër të kompetencave dhe detyrave, inspektorët e KPMM-së gjatë vitit 2010 e kanë bërë inspektimin e rregullt vjetorë të kompanisë “Sharr Beteiligungs” GmbH me ç’rast për mangësitë e identifikuar janë lëshuar vërejtjet me afatet për evitimin e tyre, të cilat monitorohen nga Inspektorati.

5.5. Licencat Minierat me eksploatim nëntokësor

Në kuadër të Trepçës janë aktive katër miniera dhe tri flotacione :

- Miniera e Stan Tërgut me Flotacion - Tuneli i Parë
- Miniera e Artanës me Flotacion - Kishnicë
- Miniera Bello Bërdo dhe
- Miniera Cërnac me Flotacion – Leposaviq

5.5.1. Miniera me Flotacion “Trepça “- Stan Tërg

Krahasuar me vitin 2009 kur është prodhuar koncentrat i Pb në sasi prej 3718 t, ka rritje për 192 t ose 4,91 %.

Krahasuar me vitin 2009 kur është prodhuar koncentrat i Zn në sasi prej 5094 t, ka zvogëlim për 374 t ose 7,34 %.

5.5.2. Miniera “Trepça” - Artanë

Krahasuar me vitin 2009 kur është prodhuar koncentrat i Pb në sasi prej 645 t, ka rritje për 85,19 t ose 11,66 %.

Krahasuar me vitin 2009 kur është prodhuar koncentrat i Zn në sasi prej 1426 t, ka rritje për 344,67 t ose 19,46%.

5.5.3. Miniera “Trepça”- Cërnac

Krahasuar me vitin 2009 kur prodhimtaria e xehes së Pb-Zn ka qenë 34,747 ton, gjatë vitit 2010 prodhimtaria e xehes së Pb-Zn është rritur në 47,072 ton, ose 35.47%

5.5.4. Miniera “Trepça”- Bello Bërdo

Krahasuar me vitin 2009 kur prodhimtaria e xehes së Pb-Zn ka qenë 3,635 ton, gjatë vitit 2010 prodhimtaria e xehes së Pb-Zn është rritur në 11,894 ton, ose 327.21%

5.5.5. Fabrikat e pasurimit të xehes - Flotacionet

Në fund të vitit 2010 është kryer pranimi teknik i fabrikës për pasurimin e kromit të kompanisë “Ferromet Kosova” J.S.C në Vogovë – Gjakovë për tu pajisur me Leje për Aktivitete të Veçanta.

5.6. Licencat e Shfrytëzimit / Lejet për Aktivitete e Veçanta

Minierat me eksploatim nëntokësor janë të pajisura me këto Licenca të Shfrytëzimit/ Leje për Aktivitet e Veçanta:

- Licenca për Shfrytëzim Nr.1021/KPMM/2010 për Minerale Metalike për Minierën e Stan Tërgut me kohëzgjatje prej 24.12.2010 deri më 23.12.2012.
- Licenca për Shfrytëzim Nr.1022/KPMM/2010 për Minerale Metalike për Minierën e Artanës me kohëzgjatje prej 24.12.2010 deri më 23.12.2012.
- Vendimi i Bordit me Nr. Ref.001/2010 më 02.02.2010 për ushtrimin e të gjitha të drejtave të poseduesit të Licencës për Shfrytëzimin e Mineraleve Metalike për Minierën e Bello Bërdos për periudhën kohore prej një viti nga data e nxjerrjes së vendimit dhe Vendimi Nr. Ref.001/2011 më 01.02.2011 për vazhdimin e periudhës kohore edhe për gjashtë muaj.
- Vendimi i Bordit me Nr. Ref.002/2010 më 02.02.2010 për ushtrimin e të gjitha të drejtave të poseduesit të Licencës për Shfrytëzimin e Mineraleve Metalike për Minierën e Cërnacit për periudhën kohore prej një viti nga data e nxjerrjes së vendimit dhe Vendimi Nr. Ref.002/2011 më 01.02.2011 për vazhdimin e periudhës kohore edhe për gjashtë muaj.

Leja për Aktivitet e Veçanta Nr.214/KPMM /2010 më 21.10.2010 për të kryer punët e hidrombushjes duke përfshirë mbushjen e hapësirave nga shfrytëzimi i xehes në Minierën e Bello-Bërdos për periudhën kohore deri sa është i vlefshëm Vendimi Nr.Ref.001/2010 i datës 01.10.2010.

5.7. Gjendja e Kompanive të Licencuara:

Sa i përket përmbushjes të obligimeve të kompanive të licencuara për shfrytëzim dhe për punë të veçanta konstatojmë më sa vijon:

Në aspektet ligjore, kompanitë e licencuara nga KPMM janë duke ju përmbajtur obligimeve ligjore por jo në nivelin e kërkuar për shkak se shumë kompani-gurore janë në fazën e hapjes dhe zhvillimit të karriereve.

Kompanitë - operatorët e licencuar janë duke angazhuar inxhinierë përgjegjës adekuat nëpër kompanitë e tyre, të cilët po marrin përgjegjësitë e punëve në aspektet teknike dhe të sigurisë.

Raportimet e punëve nga ana e kompanive janë duke u bërë në baza tre mujore dhe vjetore sipas Ligjit Nr. 03/ L-163 Për Minierat dhe Minerale.

Disa kompani nuk ju përmbahen kushteve të mbrojtjes së ambientit. Sistemi për largimin e pluhurit të gurëthyesit nuk është plotësisht funksional. Tek disa baza të asfaltit nuk bëhet ndërrimi i rregullt i filtrave kështu që Inspektorati i Minierave ka ndërmarrë masa, duke u lëshuar vërejtje për eliminimin e shkaktarëve për ndotjen e ambientit.

Mbetet obligim i Inspektorëve të minierave që të mbikëqyrin për së afërmi zbatimin e kushteve e kriterëve të licencave dhe verifikimin e vlerave-sasive të shfrytëzimit të raportuara nga ana e kompanive.

Objektivat e Inspektoratit dhe KPMM janë duke u arritur në mënyrë graduale nga faza emergjente në fazën e menaxhimit të minierave.

1. Në fazën emergjente qëllimi ishte që ti fusim në sistem kompanitë dhe ti licencojmë me qëllim të shfrytëzimit legal të mineraleve të dobishme dhe grumbullimit të rentave minerare.
2. Ndërsa tani në fazën e menaxhimit të minierave gradualisht jemi duke i përmbushur objektivat.

5.8. Veprimtaritë Ilegale

Shfrytëzimi ilegal i resurseve natyrore ka vazhduar edhe gjatë vitit 2010 nga kompanitë ilegale dhe personat fizik.

Gjatë viti 2010 janë regjistruar dhe inspektuar gjithsej 268 raste të veprimtarive ilegale (kompanitë dhe personat fizikë), prej tyre:

- **117** janë në fushat e përpunimit
- **151** janë shfrytëzim i lëndës minerale.

Për të gjitha rastet e inspektimeve të kompanive ilegale dhe personave fizikë janë bërë raportet dhe u janë lëshuar Urdhëresat për ndërprerjen e aktiviteteve ilegale, ndërsa disa kompanive u janë vendosur shiritat për ndërprerjen e aktiviteteve ilegale.

Ndaj operuesve ilegalë janë parashtruar **170** kallëzime penale.



Figura 6. Foto me rastin e vendosjes se shiritit për operues ilegalë

Parandalimi i veprimeve ilegale kërkon bashkëpunim dhe koordinim në mes të institucioneve tjera dhe KPMM-së.

Me qëllim të parandalimit të veprimeve ilegale të shfrytëzimit dhe përpunimit të lëndëve minerare janë ndërmarr gjithsej njëzet e nëntë (29) aksione të koordinuara me Policinë e Kosovës dhe me Inspektorët e Komunave.

5.9. Lëndimet gjatë aktiviteteve minerare

Gjatë vitit 2010 në Inspektoratin e minierave janë lajmëruar katër (4) lëndime të rënda dhe një (1) lëndim me pasoja vdekjeprurëse.

Tabela 9: Lëndimet e rënda dhe lëndimet vdekjeprurëse gjatë vitit 2010

Nr. rend.	Vendi ku ka ndodhur lëndimi	Lëndime të rënda	Lëndime vdekjeprurëse
1	KEK – Departamenti i Mirëmbajtjes – Eskavatori në riparim ES-8M Mirash	1	
2	Miniera Trepça Stan Tërg – Horizonti i X – Punishtja 141		1
3	KEK – Departamenti i Serviseve – Konvejeri i vazhduar i stacionit kthyes 5/13 Mirash	1	
4	Miniera “Trepça” Artanë –Horizonti IV punishtja 798	1	
5	Kompania “Eskavatori” –Sllovi Lipjan - kamioni i tipit Dam për	1	
	Gjithsej	4	1

Gjatë viti 2009 numri i lëndimeve me pasoja vdekjeprurëse ka qenë dy (2) raste kurse me lëndime të rënda njëmbëdhjete (11) raste, përderisa gjatë vitit 2010 numri i lëndimeve me pasoja vdekjeprurëse ka qenë një (1) rast kurse me lëndime të rënda katër (4) raste. Inspektorati i minierave ka kryer hetimet detale për çdo rast dhe kanë përgatitur raporte të cilat janë dërguar në Zyrën Ligjore të KPMM-së për procedim në gjykata.

Shkaktarët më të shpeshtë të aksidenteve dhe avarive në miniera dhe objektet përpunuese minerare radhiten si në vijim:

- Gjendja jo e mirë teknike e pajisjeve dhe stabilimenteve tekniko – teknologjike dhe manipulimi jo adekuat me to,
- Pakujdesia dhe neglizhenca e punëtorëve,
- Përdorimi i pamjaftueshëm e pajisjeve personale mbrojtëse,

➤ Mungesa e njohurive dhe aftësimeve profesionale.

Sa i përket gjendjes së sigurisë në punë tek kompanitë e licencuara si dhe a janë duke u kryer shfrytëzimet, përpunimet e operimet sipas projekteve të parapara, konstatojmë më sa vijon:

- Të gjitha aktivitetet e minimeve inspektohen dhe kontrollohen nga ana e Inspektorëve të minierave si gjatë përgatitjes – shpimit të fushave minuese ashtu edhe gjatë minimeve dhe pas minimeve.
- Gjatë gjithë kohës të këtyre aktiviteteve me rigorizëm zbatohen masat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë.

6. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT TË GJEOLGJISË

Departamenti i Gjeologjisë në kuadër të KPMM-së përveç tjerash ka edhe rolin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës dhe ka realizuar disa projekte që lidhen me krijimin e informacioneve gjeologjike bazë që duhet t'i ketë një shtet, si Hartat Gjeo-shkencore, matjet gjeofizike nga ajri, matjet gjeokimike (që janë bërë vetëm për një pjesë të vogël të territorit të Kosovës), etj.

Përveç kësaj, përmes Departamentit të Gjeologjisë janë proceduar kërkesat për licenca hulumtimi dhe shfrytëzimi, si dhe është mbajtur baza e të dhënave mbi shfrytëzimin e resurseve minerale në Kosovë.

Duke u bazuar në raportimet e rregullta të kompanive minerare posedues të licencave të shfrytëzimit, si dhe verifikimeve që bëhen nga departamentet përkatëse, sektori i resurseve minerale mban shënime të rregullta mbi sasitë e shfrytëzimit të lëndëve të para minerale.

Më poshtë janë paraqitur në formë tabelore dhe grafike sasitë e shfrytëzuara sipas lëndëve të para minerale¹: minerale ndërtimore, minerale metalike dhe linjiti.

Tabela vijuese paraqet rezervat e shfrytëzuara nga kompanitë, sipas llojeve të resurseve minerale, gjatë TM1, TM2, TM3, TM4 2010

Tabela 10: Rezervat e shfrytëzuara nga kompanitë – gjatë TM1, TM2, TM3, TM4 2010

Nr. rendor.	Lënda minerale për shfrytëzim	E planifikuar	E realizuar	Ndryshimi	Realizimi në %	Njësia matëse
1	Gëlqeror	4,892,787	2,616,849	2,275,937	53.48%	m3
2	Rërë dhe Zhavorr	172,758	18,533	154,225	10.73%	m3
3	Mergel	975,048	302,630	672,418	31.04%	m3
4	Andezite	250,000	41,812	208,188	16.72%	m3
5	Proluvion	4,129	4,129	0	100.00%	m3
6	Argjilë	123,279	34,425	88,854	27.92%	m3
7	Rëra kuarcore	61,000	17,333	43,667	28.41%	m3
8	Andezite-Bazalte	100,000	9,400	90,600	9.40%	m3
9	Dunite	8,621	11,166	-2,545	129.52%	m3
10	Harcburgiti	8,621	11,166	-4,700	129.52%	m3

¹ Për gëlqerorë dhe andezite të dhënat janë nga raportet e minimit, kurse për resurset tjera nga raportimi i kompanive




Figura 7. Prodhimtaria e mineraleve ndërtimore dhe industriale për vitin 2010

Tabela 11: Prodhimtaria e mineraleve ndërtimore dhe industriale 2005 - 2010

Mineralet industriale dhe ndërtimore								
Rezervat e shfrytëzuara nga kompanitë për periudhën 2005-2010								
		2005	2006	2007	2008	2009	2010	
1	Gëlqeror	629,612	777,491	879,797	1,917,196	2,164,589	2,616,849	m3
2	Rërë dhe Zhavorr	14,894	35,650	41,621	45,463	46,085	18,533	m3
3	Mergel	264,814	254,386	260,707	322,007	291,829	302,630	m3
6	Andezite	0	19,940	36,321	45,005	58,778	41,812	m3
7	Proluvion	4,515	3,800	2,610	3,121	2,620	4,129	m3
9	Argjilë	0	0	27,614	35,382	78,813	34,425	m3
12	Rëra kuarcore	0	0	26,800	27,325	20,181	17,333	m3
13	Andezite-Bazalte	0	0	0	0	7,194	9,400	m3
	Dunite	0	0	0	0	0	11,166	m3
14	Harcburgite	0	0	0	0	8,788	4000	m3




Figura 8. Paraqitja grafike e prodhimitarisë së mineraleve ndërtimore 2005 - 2010




Figura 9. Prodhimi i gëlqerorëve sipas viteve 2005 – 2010

Tabela 12: Planifikimi dhe realizimi i prodhimit për gëlqerorë 2005 – 2010

	2005		2006		2007		2008		2009		2010	
Lënda minerale	Planifikimi	Realizimi	Planifikimi	Realizimi	Planifikimi	Realizimi	Planifikimi	Realizimi	Planifikimi	Realizimi	Planifikimi	Realizimi
Gëlqeror m³	2,879,858	629,612	3,554,518	777,491	2,888,558	879,797	4,475,713	1,917,196	4,956,127	2,164,589	4,892,787	2,616,849




Figura 10. Prodhimi i rërës dhe zhavorrit sipas viteve 2005 – 2010

Tabela 13: Planifikimi dhe realizimi i prodhimit për rërë dhe zhavorr 2005 – 2010

	2005		2006		2007		2008		2009		2010	
Lënda minerale	Planifikimi	Realizimi	Planifikimi	Realizimi	Planifikimi	Realizimi	Planifikimi	Realizimi	Planifikimi	Realizimi	Planifikimi	Realizimi
Rërë dhe Zhavorr m ³	18,500	14,894	185,536	35,650	212,518	41,621	225,034	45,463	195,340	46,085	172,758	18,533

Siç vërehet nga grafikët, kemi një mospërputhje të konsiderueshme në mes të sasisë së planifikuar (projektuar) të shfrytëzimit dhe sasisë së realizuar. Arsyeja kryesore është se kompanitë e licencuara kanë një konkurrencë jolojale në treg për shkak të aktiviteteve ilegale të shfrytëzimit. Kjo ka rezultuar që kompanitë e licencuara të reduktojnë prodhimin.




Figura 11. Prodhimi i xehes së Nikelit 2006 - 2010




Figura 12. Prodhimtaria e xehes së Pb-Zn 2005 – 2010




Figura 13. Prodhimi i lignitit 2005 – 2010

6.1. Arkivi

Në kuadër të Departamentit të Gjeologjisë ekziston edhe Arkivi i KPMM-së, në të cilin hyn dhe Arkiva gjeologjike. Arkiva Gjeologjike ofron shërbime përveç KPMM-se edhe kompanive të interesuara për investime në sektorin minerar në Kosovë si dhe institucioneve tjera të cilave ju nevojiten të dhënat gjeologjike për të përgatitur planet zhvillimore lokale dhe qendrore. Vlen të përmendet se KPMM ka një arkiv të digjitalizuar dhe të gjitha procedurat e arkivimit janë të digjitalizuara.

7. FINANCAT

Buxheti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në tabelën e mëposhtme është prezantuar nga viti 2005 deri në vitin 2010. Ky buxhet është prezantuar në 5 linja buxhetore.

Tabela 14: Buxheti i aprovuar për vitet 2005-2010

Nr. Ren.	Përshkrimi	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
1	Paga dhe Mëditje	169,000	167,039	249,782	312,948	586,148	562,507
2	Mallra dhe Shërbime	796,000	489,753	456,390	368,885	491,447	523,095
3	Komunali		30,000	30,000	30,000	36,000	36,000
4	Subvencione		-	-	-	36,000	20,000
5	Projekte Kapitale	1,000,000	1,115,000	1,167,000	120,000	370,500	317,729
Total		1,965,000	1,801,792	1,903,172	831,833	1,520,095	1,459,331

Buxheti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2010 ka qenë i ndarë në këto 5 (pesë) linja buxhetore si me poshtë.

Tabela 15: Aprovimi i buxhetit në fillim të vitit 2010

Nr. Ren.	Përshkrimi	Viti 2010
1	Paga dhe Mëditje	491,447.00 €
2	Mallra dhe Shërbime	602,148.00 €
3	Komunali	36,000.00 €
4	Subvencione dhe Transfere	20,000.00 €
5	Projekte Kapitale	325,000.00 €
Totali i Aprovuar		1,474,595.00 €




Figura 14. Grafiku i buxhetit të aprovuar fillestar për vitin 2010

Duke e pasur parasysh ndryshimet që kanë qenë pas ndarjes së buxhetit fillestar, në tabelën e mëposhtme është prezantuar buxheti final për vitin 2010.

1. Me 19.02.2010 me një vendim të MEF-it janë marrë buxhet nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime në vlerë prej 19,053.00 €, pra buxheti ka rënë nga 602,148.00 € në 583,095.00 €

2. Ndryshimi i dytë ka ndodhur në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje, në emër të rritjes për paga nga 30 € në muaj për punëtorë. KPMM-ja nga kjo rritje ka përfituar buxhet shtesë 16,560.00 €, me ç'rast buxheti është rritur nga 491,447.00 € në 508,007.00 €.

3. Në fund të vitit me vendim të Qeverisë (me 05.11.2010), janë bërë disa ndryshime në buxhetin e KPMM-së:

3.1 Prej projekteve kapitale janë marrë 7,217.00 €,

3.2 Prej kategorisë ekonomike mallra dhe shërbime janë marrë 60,000.00 €,

3.3 Nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës, nga kategoria ekonomike P&M janë bartë në KPMM në kategorinë ekonomike P&M 54,500.00 €

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur buxheti përfundimtar për KPMM-në.

Tabela 16: Aprovimi i buxhetit përfundimtar në vitin 2010

Nr. Ren.	Përshkrimi	Viti 2010
1	Paga dhe Mëditje	562,507.00 €
2	Mallra dhe Shërbime	523,095.00 €
3	Komunali	36,000.00 €
4	Subvencione	20,000.00 €
5	Projekte Kapitale	317,729.00 €
	Totali i Aprovuar	1,459,331.00 €




Figura 15. Grafiku i buxhetit të aprovuar përfundimtar për vitin 2010

Ne tabelën e mëposhtme kemi prezantuar buxhetin e aprovuar dhe të shpenzuar.

Tabela 17: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar në vitin 2010

Nr. Ren.	Përshkrimi	Aprovuar	Shpenzuar	Ndryshimi	Ne %
1	Paga dhe Mëditje	562,507.00 €	558,594.93 €	3,912.07 €	99.30
2	Mallra dhe Shërbime	523,095.00 €	500,635.19 €	22,459.81 €	95.71
3	Komunali	36,000.00 €	28,652.26 €	7,347.74 €	79.59
4	Subvencione	20,000.00 €	19,749.00 €	251.00 €	98.75
5	Projekte Kapitale	317,729.00 €	290,970.24 €	26,758.76 €	91.58
	Totali i Aprovuar	1,459,331.00 €			
	Totali i Shpenzuar		1,398,601.62 €		
	Totali në %				95.84




Figura 16. Grafiku i buxhetit të aprovuar dhe shpenzuar gjatë vitit 2010

Ne tabelën e mëposhtme janë prezantuar Shpenzimet për paga dhe mëditje, Pagat neto, tatimi, dhe pensionet e punëtorit dhe punëdhënësit.

Tabela 18: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për paga në vitin 2010

Nr. Ren.	Pershkrimi	Aprovuar	Shpenzuar	Diferenca	Ne %
1	Pagat Neto	476,507.00	474,124.79	2,382.21	99.5
2	Tatimi ne Paga	32,000.00	31,268.68	731.32	97.7
3	Kontributi i Punëtorëve	27,000.00	26,600.73	399.27	98.5
4	Kontributi i Punëdhënsit	27,000.00	26,600.73	399.27	98.5
	Total	562,507.00	558,594.93	3,912.07	99.3




Figura 17. Grafiku i buxhetit të aprovuar dhe shpenzuar për paga gjatë vitit 2010

Ne tabelën e më poshtme është paraqitur buxheti i aprovuar, shpenzuar, diferenca dhe është prezantuar në %, për kategorinë ekonomike Komunali

Tabela 19: buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për komunalitetin në vitin 2010

Nr. Ren.	Pershkrimi	Te Planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca	Ne %
1	Rryma	15,000.00 €	13,540.45 €	1,459.55 €	90.27
2	Telefoni dhe faksi	19,500.00 €	13,178.87 €	6,321.13 €	67.58
3	Shpenzimet e Ujit	1,500.00 €	1,717.94 €	- 217.94 €	114.53
4	Vendime Gjyqësore	- €	215.00 €	- 215.00 €	#DIV/0!
	Totali	36,000.00 €	28,652.26 €	7,562.74 €	79.59




Figura 18. Grafiku i buxhetit të aprovuar dhe shpenzuar për komunalitetin gjatë vitit 2010

Ne vazhdim është prezantuar tabela e subvencioneve dhe transfereve

Tabela 20: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për Subvencione në vitin 2010

Nr. Ren.	Pershkrimi	Te Planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca	Ne %
1	Subvencione dhe Transfere	20,000.00 €	19,749.00 €	251.00 €	0.99
	Totali	20,000.00 €	19,749.00 €	251.00 €	0.99




Figura 19. Grafiku i buxhetit për subvencione dhe transfere gjatë vitit 2010

Ne vazhdim është prezantuar tabela e projekteve kapitale

Tabela 21: Buxheti i aprovuar dhe i shpenzuar për projekte kapitale në vitin 2010

Nr. Ren.	Pershkrimi	Te Planifikuara	Te Shpenzuara	Diferenca	Ne %
2	Ndertimi i planshetave te Harts Gj	140,500.00 €	136,200.00 €	4,300.00 €	96.9
3	Menaxhimi i Resurseve Minerale	128,479.00 €	115,600.00 €	12,879.00 €	90.0
4	Blerja e dy veturave	39,500.00 €	29,980.01 €	9,519.99 €	75.9
5	Server	9,250.00 €	9,190.23 €	59.77 €	99.4
	Totali	317,729.00 €	290,970.24 €	26,758.76 €	91.6




Figura 20. Grafiku i buxhetit për projekte kapitale gjatë vitit 2010

Vlera e obligimeve financiare të realizuara gjatë vitit 2010 e të papaguara, të bartura në vitin 2011 është 13,539.45€.

Realizimi i te Hyrave ne vitin 2010

Ne tabelën e me poshtme është prezantuar inkasimi i te hyrave gjatë vitit 2010

Tabela 22: Inkasimi i të hyrave gjatë vitit 2010

Pershkrimi	Kodi ekonomik	Total faturuar 2010	Inkasim për vitin 2010	Borxh 2010	Inkasim për vitin 2007	Inkasim për vitin 2008	Inkasim për vitin 2009	Inkasim për vitin 2010	Total 2010
a	b	c	d	e=c-d	f	g	h	i	j=f+g+h+i
Taksa Admin	50019	321,665.20	191,210.52	130,455	4,000	8,463.13	35,208.07	191,210.52	238,881.73
Gjoba Admin	50107	2,750.00	750.00	2,000	-	-	3,700.00	750.00	4,450.00
Faturimi	50203	4,975,130.94	4,391,058.16	584,073	176,771	1,002,859.95	2,646,516.54	4,391,058.16	8,217,205.51
					-	-	-		-
Totali		5,299,546.14	4,583,019	716,527	180,771	1,011,323.08	2,685,424.61	4,583,018.68	8,460,537.24

Tabela 23: Faturimi dhe inkasimi gjatë vitit 2010

Nr. Rend.	Përshkrimi	Faturimi 2010	Inkasimi 2010	Bilanci
1	Taksa Administrative	321,665.20	238,881.73	82,783.47
2	Gjoba Administrative	2,750.00	4,450.00	- 1,700.00
3	Renta Minerare	4,975,130.94	8,217,205.51	- 3,242,074.57
	Totali	5,299,546.14	8,460,537.24	- 3,160,991.10

Pra siç shihet ne tabelën e me sipërme janë inkasuar me shumë se sa janë faturuar për 3,160,991.10 €, arsye për këtë është inkasimi i obligimeve nga vitet paraprake.




Figura 21. Grafiku i faturimit dhe inkasimit gjatë vitit 2010

Sa i përket sqarimeve, siç shihet ne grafik ne mes te faturimit dhe inkasimit për vitin 2010, janë te shpalosura ne tabelën e mësipërme.

Në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm janë të paraqitura të hyrat që ka realizuar KPMM gjatë periudhës kohore 2005-2010.

Tabela 24: Të hyrat e realizuara gjatë periudhës 2005-2010

Viti	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Të hyrat	29,962.13 €	2,630,052.67 €	2,029,092.64 €	5,021,236.48 €	4,465,259.68 €	8,460,537.24 €




Figura 22. Të hyrat e realizuara gjatë periudhës 2005-2010

Vërejtje: Minierat e Trepçës nuk i kanë kryer obligimet financiare ndaj KPMM-së për pagesën e rentës minerare:

-	Miniera e Trepçës në Stantërg	820,738.29€
-	Miniera e Trepçës në Artanë	252,967.27€
-	Miniera e Trepçës në Cërnac	379,717.62€
-	Miniera e Trepçës në Bellë Bërdë	53,840.09€

Borxhi total i minierave të Trepçës është: **1,507,263.27€**

8. AKTIVITETET E TJERA

8.1. GIS-i (Gjeo-databaza e të dhënave)

Në bazë të nenit 56 të Ligjit Nr 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, KPMM është përgjegjës edhe për themelimin dhe mirëmbajtjen e një kadastrë të minierave dhe një baze të të dhënave GIS që përmban të dhëna gjeologjike dhe të dhëna të tjera relevante ekonomike si dhe të gjithë titujt ekzistues të mineraleve dhe të drejtave minerare.

Për të përmbushur këtë funksion Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) ka Sistemin Informativ të Menaxhimit (SIM), Geo-Databazën e Kosovës (SIM, GDK) si Kadastrë të minierave të Kosovës. GDK përkrah disa procese të punëve të KPMM-së, përfshirë menaxhimin dhe lëshimin e Licencave për Hulumtim, Shfrytëzim si dhe Lejeve për Aktivitete të Veçanta.

Përveç kësaj, GDK menaxhon të gjitha të dhënat e KPMM-së të ruajtura në mënyrë elektronike (siç janë dokumentet dhe raportet, hartat gjeoshkencore, të dhënat e vendburimit mineral, arkivin dhe të tjera).

SIM- GDK përbëhet nga disa module që bashkëveprojnë me njëra-tjetrën. Komponentët kryesorë të sistemit janë: databaza Microsoft SQL Server 2000 me ArcSDE v 8.3, moduli për menaxhimin e të dhënave të ambientit, GUI që përbëhet nga VB. Basic. NET Rrjet gjithëpërfshirës, dhe ESRI ArcMap v 8.3 i rregulluar dhe aplikimi i objekteve të hartës ESRI.

Sektori mineral luan një rol kyç në rindërtimin e ekonomisë në Kosovë dhe perspektivat e të ardhmes së vendit. Një SIM i ri dhe që funksionon mirë, i cili u jep investitorëve qasje direkte në të dhënat e sektorit mineral, është një parakusht për mbarëvajtjen e mëtutjeshme të zhvillimit të sektorit mineral në Republikën e Kosovës.

SIM bën menaxhimin e ndryshimeve të kushteve të brendshme dhe të jashtme, siç janë strukturat administrative, legjislacioni, teknologjitë e zhvillimit të shpejtë të softuerit dhe harduerit, si dhe sasia e rritur shpejtë si të dhënave edhe të përdoruesve.

Përmes GIS-it, KPMM përveç që e përdor për nevoja të licencimit dhe të ofrimit të informatave investitorëve të interesuar, iu ofron informata edhe ministrive dhe komunave të Kosovës, siç janë MZHE, MMPH etj., me të cilat u ndihmon në hartimin e politikave zhvillimore dhe planifikimeve hapësinore.

Departamenti i GIS-it gjatë vitit 2010 ka arritur të përpilojë një numër të hartave tematike sipas kërkesave të parashtruara nga kompanitë private, vendore dhe ndërkombëtare, si dhe nga institucionet e ndryshme: Ministrit, komunat, KFOR etj.

Gjithsej, harta të përgatitura gjatë vitit 2010 janë: 160 sosh




Figura 23. Pamje nga Gjeo-databaza e KPMM-se

8.2. GJEODEZIA

Departamenti i Gjeodezisë gjatë vitit 2010 ka bërë: shqyrtimin i aplikacioneve, verifikimin e tyre duke përfshirë vizitat në terren më qëllim të konstatimit të korrektesisë së aplikacioneve, raportet për secilin aplikacion të shqyrtuar veç e veç, verifikimin e koordinatave para çdo minimi, matjet për qëllime të kalkulimit të saktë të sasive të shfrytëzuara.

Për çdo aplikacion që dorëzohet në KPMM me kërkesë për licencë hulumtimi, shfrytëzimi apo leje të veçantë. Ky raport përqendrohet kryesisht në studimin rreth fletës poseduese, kopjes së planit, pëlqimit komunal, pëlqimit të ambientit, pëlqimit të pylltarisë, dhe situacionit duke përfshirë rrjetin gjeodezik.

Pas shqyrtimit detal të aplikacioneve, në rast se të gjitha parakushtet janë plotësuar, atëherë vazhdohet më verifikimin e lokacionit. Ky verifikim zakonisht bëhet në terren ku kontrollohen së paku katër pika.

Gjatë vitit 2010 nga Departamenti i Gjeodezisë në bashkëpunim me departamentet e tjera ka kryer matjet gjeodezike të operatorët të cilat shfrytëzimin e lëndëve të para minerale e kanë bërë në mënyrë ilegale.

Shuma e materialit të shfrytëzuar nga operatorët ilegale është 1,524,673.00 m³

8.3. DEPARTAMENTI LIGJOR

Gjatë vitit 2010 Departamenti Ligjor i KPMM-se ka kryer punë dhe detyra të cilat janë të parapara sipas ligjeve në fuqi, siç janë pranimi i aplikacioneve për licenca hulumtimi, shfrytëzimi si dhe leje për aktivitete të veçanta. Po ashtu janë hartuar një numër i udhëzimeve administrative dhe rregulloreve në përputhje me ligjet në fuqi, veçanërisht me Ligjin Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet.

Departamenti Ligjor në vitin 2010 e ka avancuar shumë rolin e KPMM-së në realizimin e detyrave në përgjithësi, si dhe denoncimeve penale në veçanti për operuesit ilegalë.

KPMM si institucion mund të bëjë vetëm kallëzime penale, kurse ndjekjen penale e bën Prokuroria Publike në bazë të autorizimeve ligjore dhe kushtetuese.

KPMM ka arritur që të avancojë bashkëpunimin me prokurorinë, si dhe institucionet tjera relevante.

Numri i kallëzimeve penale të paraqitura gjatë vitit 2010 është si vijon:

Tabela 25: Kallëzimet penale gjatë vitit 2010

Regjioni Prishtinës	57
Regjioni Pejës	61
Regjioni Prizrenit	35
Regjioni i Gjilanit	13
Regjioni Mitrovicës	4
Gjithsejtë	170

Prej numrit të lartcekur të cilat KPMM i ka paraqitur në prokurori, vetëm 6 raste janë dënuar nga Gjykatat, dhe atë: 2 raste janë gjykuar në Gjykatën Komunale Deçan, dhe 4 raste janë gjykuar në Gjykatën Komunale në Pejë.

Të gjitha këto aktgjykime nuk e kanë dënimin e merituar në raport me veprën penale, ngase veprat penale janë dukshëm me dëme më të mëdha materiale në krahasim me dënimin e shqiptuar.

KPMM nuk mund të ushtrojë ankesë për veprat penale për të cilat ne i kemi paraqitur dhe për të cilat po gjykatat kanë dhënë aktgjykimet. Kodi i Procedurës Penale i lejon prokurorit publik dhe të dëmtuarit me paraqit ankesë vetëm në disa raste të parashikuara shprehimisht me KPPK.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, duke u bazuar në nenin 24.10 dhe 34.7 janë dërguar njoftimet të të gjitha kompanitë e licencuara për hulumtim dhe shfrytëzim, ku gjithsejtë kanë qenë 294 njoftime me të cilat janë njoftuar kompanitë se duhet të kthejnë në KPMM licencat, ku më pastaj Departamenti Ligjor i ka përgatitur licencat e reja.

Po ashtu KPMM ka bërë shqyrtimin e ankesave - lëndëve të kompanive të cilat shqyrtohen nga Komisioni Shqyrtues dhe të cilat pas shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve nga Bordi, nga Departamenti Ligjor janë përgatitur gjithsej 33 vendime.

Po ashtu janë përgatitur edhe këto vendime si më poshtë:

- 24 vendime për operime ilegale të cilave u është shqiptuar gjobe administrative,
- 30 vendime për mospërputhshmëri me kriteret e licencës të cilave u është shqiptuar gjobe administrative,
- 60 vendime për mospërputhshmëri me kushtet e licence së hulumtimit.

Në KPMM janë pranuar gjithsej 6549 dokumente, kurse dokumente që kanë dalë nga KPMM janë 3990.

Ne bashkëpunim me departamentet tjera është bërë identifikimi i operatorëve të licencuar që nuk e kanë paguar rentën minerare dhe që nuk kanë raportuar ashtu si parashihet në licence është bërë procedimi i tyre sipas nenit 9 e në lidhje me nenin 53.1

Ku janë përgatitur Aktvendime me Urdhëresa për pezullim të licencave të cilat kompani nuk i janë përmbajtur kushteve të licencimit Hulumtim dhe Shfrytëzim.

Janë dërguar shumë shkresa me qëllim të bashkëpunimit ndërinstitucional të KPMM-se dhe institucioneve tjera të Republikës së Kosovës.

8.4. ADMINISTRATA

Departamenti i Administratës në vete përmban Divizionin e Transportit dhe Logjistikës, Sektorin e Personelit si dhe Sektorin Gjuhësor. Sikurse viteve të mëparshme, edhe gjatë vitit 2010, Departamenti i Administratës është angazhuar që t'u japë përkrahjen administrative departamenteve tjera si dhe KPMM-së në tërësi, në mënyrë që punët profesionale të kryhen sipas planit të punës.

Vlen të theksohet se KPMM ka një personel me kuadër mjaft të kualifikuar, siç mund të shihet edhe në grafikun e mëposhtëm.




Figura 24. Grafiku i kualifikimeve të stafit të KPMM gjatë vitit 2010

8.5. TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

KPMM ka një strukturë të veçantë dhe të pavarur të Teknologjisë Informative. Në kuadër të kësaj infrastrukture janë të gjitha shërbimet dhe informatat që nevojiten të ketë një institucion. Departamenti i Teknologjisë Informative gjatë vitit 2010 e ka mirëmbajtur tërë sistemin duke e bërë atë funksional për të ruajtur të dhënat dhe projektet që ndërlidhen në lëmin e minierave dhe mineraleve si dhe duke e pasuruar me informata shumë të rëndësishme për kompanitë që janë të interesuara për të investuar në Kosovë.

DTI ka mirëmbajtur këtë sistem i cili përfshin këto shërbime që janë të ndërlidhura ngushtë me njëra tjetrën siç janë: Sistemin Informativ Gjeografik - GIS, Gjeodatabazën, Ueb faqen www.kosovo-mining.org, Sistemin e Email-ave (Exchange), Sistemin për monitorimin e thirrjeve telefonike, Sistemin për monitorimin e vijimit të punëtorëve në punë, si dhe punët tjera të nevojshme për mbarrëvajtjen e sistemit informativ në KPMM.

8.6. PROKURIMI

Departamenti i Prokurimit i KPMM-së është themeluar në bazë të ligjit mbi prokurimin publik të Kosovës si dhe kryen aktivitetet e prokurimit në harmoni me këtë ligj.

Gjatë vitit 2010 departamenti i Prokurimit ka kryer gjithsejtë 76 aktivitete të prokurimit të cilat kanë rezultuar me nënshkrime të kontratave ndërsa vlera e shpenzimeve të këtyre kontratave është gjithsejtë 488,631.9€. Nga aktivitetet e prokurimit vlen të përmenden projektet kapitale zhvillimore si mëposhtë:

1. Përpilimi i Katër Plansheteve të Hartës Gjeologjike të Kosovës
2. Plani i Menaxhimit të Resurseve Minerale të Kosovës

8.7. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

NjAB, funksionon në bazë të Ligjit Nr. 03/L-128 Për Auditimin e Brendshëm. Në përbërjen e vetë njësia përmban një auditor të vetëm, njëkohësisht auditori ka edhe funksionin e Udhëheqësit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar apo janë në proces këto aktivitete: Lejet për Aktivitet e Veçanta, Menaxhimi i Automjeteve, Burimet Njerëzore. Poashtu janë dërguar raportet e rregullta tremujore dhe raporti vjetor 2010, për Njësine Qendrore Harmonizuese të Auditimit të brendshëm (NjQHAB) nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në KPMM.

9. PROBLEMET NË SEKTORIN MINERAR

Aktivitetin e KPMM-së gjatë vitit 2010 e kanë shoqëruar disa vështirësi të cilat kanë ndikuar në efikasitetin e këtij institucioni mjaftë të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. Problemet e identifikuara gjatë punës së KPMM-së janë:

a. Numri i madh i kërkesave dhe ankesave

Prej muajit korrik të vitit 2009, Bordi i KPMM-së ka qenë jo funksional sepse ishte vetëm me dy anëtar aktiv për çka ka qenë e pa mundshme – jo ligjore marrja e vendimeve dhe shqyrtimi i Kërkesave dhe ankesave të parashtruara.

Në fund të muajit Janar 2010 Kuvendi i Republikës së Kosovës bëri emërimin e katër anëtarëve të Bordit dhe me 1 shkurt 2010 Bordi i KPMM –së ishte i kompletuar.

Prandaj me fillimin e punës gjatë vitit 2010, Bordit i është dashur që të merret me shqyrtimin e shumë punëve – apo kërkesave dhe ankesave të grumbulluara prej vitit paraprak. Numri i Kërkesave për licencim ishte më tepër se 150, kurse numri i ankesave ishte mbi 30. Nga kjo shihet se Bordit i është dashur një punën e shtuar për me i shqyrtuar të gjitha këto lëndë të grumbulluara dhe shqyrtimin e atyre që janë paraqit gjatë vitit 2010.

b. Shfrytëzimet ilegale dhe mosrespektimi i standardeve ambientale

Një prej shqetësimeve kryesore që është trashëguar nga vitet e mëparshme, për KPMM gjatë vitit 2010 kanë qenë edhe operimet ilegale të mineraleve ndërtimore dhe mosrespektimi i standardeve ambientale nga ana e kompanive të licencuara.

Operimet ilegale - Mund të konstatojmë se një prej problemeve më të mëdha që po e rëndojnë punën dhe aktivitetin minerar në Kosovë janë operimet ilegale. Me një angazhim maksimal që është bërë gjatë vitit 2010, po shihet se pjesa më e madhe e operatorëve ilegal çdo ditë e më tepër po e kuptojnë se duhet t'iu nënshtrohen rregullave dhe respektimit të Ligjeve.

Inspektorati i KPMM-së vazhdimisht ka lëshuar dhe është duke lëshuar urdhëresa për ndërprerje të këtyre operimeve ilegale, mirëpo duke munguar fuqia ekzekutive e këtyre urdhëresave, disa prej operatorëve ilegalë vazhdojnë operimin pa ndonjë shqetësim.

Efektet negative që janë duke shkaktuar operuesit ilegalë janë të shumëfishta, duke filluar nga:

- shkatërrimi i ambientit,
- ikja nga tatimi,
- ikja nga pagesa e rentës minerare,
- konkurrenca jo lojale ndaj kompanive të licencuara të cilat i kryejnë të gjitha obligimet ndaj shtetit të Kosovës,
- ofrimi i kualitetit të dobët dhe të pakontrolluar të materialeve për asfaltimin e rrugëve dhe ndërtimtarisë në përgjithësi,
- si pasojë e kualitetit të dobët të materialit të ofruar krijohen shpenzime të panevojshme të buxhetit të Kosovës në riasfaltim të rrugëve dhe mirëmbajtje të tyre, etj.

Në bazë të Rregullores 2005/3, dhe me miratimin e Ligjit për Minierat dhe Mineralet Nr. 03/L-163 është bërë lëshimi apo shqiptimi i gjobave administrative mbi veprimet ilegale, mirëpo këto gjoba nuk mund të ekzekutohen në mungesë të një pune më aktive dhe efikase të Prokurorive dhe Gjykatave.

c. Mungesa e legjislacionit për sektorin minerar

Mungesa e legjislacionit sekondar për sektorin minerar është edhe një problem tjetër i cili KPMM-së vazhdimisht i shkakton vështirësi në kryerjen e punëve:

- Rregullorja për siguri dhe mbrojtje në punë
- Rregullorja për klasifikimin dhe verifikimin e rezervave gjeologjike
- Rregullorja për pranimin teknik të objekteve minerare, etj.

KPMM ka vërejtje edhe në Ligjin për Minierat dhe Mineralet, dhe në një moment të përshtatshëm do t'i dërgojë ndarazi institucioneve kompetente komentet e saja lidhur me vështirësitë me të cilat ballafaqohet në punët e përditshme gjatë implementimit të këtij ligji.

d. Koordinimi ndërinstitutional

Siç e kemi cekur edhe tek operimet ilegale, koordinimi ndërinstitutional është çelës për krijimin e rendit dhe implementimin e ligjit në sektorin minerar. Mungesa e një koordinimi të mirë po vështirëson ndalimin e operimeve ilegale dhe implementimin e standardeve ndërkombëtare për mbrojtje të ambientit. Të gjitha këto po i inkurajojnë me të madhe aktivitetet e shkelësve të ligjit. Me kërkesë të inspektorëve, Policia e Kosovës nuk po mund të jetë implementuese e ligjit për miniera, për arsye se i pengon mangësia e infrastrukturës ligjore, e nevojshme për ta mbështetur kërkesat e KPMM-së në teren.

e. Mungesa e objektit të përhershëm

KPMM vazhdimisht ka komunikuar me shkrim dhe verbalist me të gjitha institucionet relevante për gjetjen e mundësisë së vendosjes në një objekt shtetëror, i cili do të na mundësonte vendosje afatgjate. Me gjithë faktin e angazhimit tonë vazhdojmë të jemi një ndër institucionet e pakta që nuk na është bërë zgjedhje në këtë aspekt.

10. SYNIMET PËR TË ARDHMEN

a. Ndalimi i operimeve ilegale dhe ngritja e kualitetit të punës te kompanitë e licencuara

Një ndër synimet kryesore të KPMM-së, në vazhdimësi edhe për vitin 2011 është ndalimi i operuesve ilegalë në sektorin minerar. Edhe pse gjatë vitit 2010 janë arritur rezultate të mira, KPMM në bashkëpunim me institucionet të tjera, do të vazhdojë që të pamundësojë operimet ilegale në Kosovë.

b. Rritja e koordinimit ndërinstitutional

Rritja e bashkëpunimit ndërinstitutional është e domosdoshme për të arritur respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe standardeve tjera ndërkombëtare. Bashkëpunimi duhet të rritet kryesisht ndërmjet KPMM-së, prokurorive -MD, policisë- MPB-së MMPH-së si dhe komunave, etj.

c. Përafrimi i standardeve teknike me ato evropiane

Edhe pse funksionimi i sektorit minerar në Kosovë shoqërohet me një siguri të mirë, prapë se prapë KPMM është e angazhuar që në bashkëpunim me institucionet relevante të përvetësojë standardet teknike të cilat zbatohen në shtetet e BE-së.

d. Rritja e inkasimit të të hyrave nga renta minerare

Edhe përkundër rritjes së inkasimit të të hyrave gjatë vitit 2010, KPMM do të vazhdojë trendin e rritjes edhe për vitin 2011.

e. Ngritja e nivelit të shërbimeve për palët të treta

Synim i KPMM-se është që në vazhdimësi të ngrit nivelin e shërbimeve ndaj palëve të treta, duke azhurnuar UEB faqen e KPMM-së me të gjitha kërkesat dhe shpjegimet e nevojshme për klientët. Për të arritur këtë synim KPMM synon në vazhdimësi të ngrit kapacitetet profesionale të stafit.

f. Ofrimi i asistencës teknike dhe profesionale

Me kërkesë të Qeverisë, KPMM ofron asistencë teknike në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me minierat dhe mineralet në Kosovë. KPMM organizon prezantime lidhur me potencialin mineral të Kosovës për investitorët e interesuar

Me Fat!